



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

**THIRRJE PËR MODERATOR PËR EVENTIN MATCH-MAKER
ALBANIA**

DATË 27 MARS 2025

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) shpall thirrjen për moderator për eventin Match-Maker Albania, që do të zhvillohet në datë 27.03.2025, Pallati i Kongreseve, në Tiranë. Aplikantët e interesuar duhet të paraqesin një projekt-propozim që konsiston në moderimin e aktivitetit nga ana e tij dhe në realizimin e një programacioni angazhues për pjesëmarrësit përgjatë eventit.

Përshkrim i eventit dhe i asaj që pritet nga programacioni i moderatorit

Match Maker Albania është një event që ka si synim të krijojë mundësi për të lidhur eksportuesit shqiptarë me tregjet ndërkombëtare, për të prezantuar investime vendase dhe të huaja në Shqipëri, për të shfaqur potencialin e vendit tonë dhe për të krijuar bashkëpunime të reja me kompani globale.

Një sërë ngjarjesh biznesi pritet të ndodhin në këtë event, ku në një vend të vetëm do bashkohen institucione, kompani dhe investitorë nga vende të ndryshme të botës, me synim krijimin e bashkëpunimeve të frytshme.

Duke qenë se në event do jenë pjesëmarrës të rëndësishëm nga bota e biznesit nga vende të ndryshme dhe për faktin se eventi është i mbushur me aktivitete biznesi, lind nevoja e një moderator dhe njëkohësisht krahas moderimit, duhet që moderatorit të realizojë dhe një programacion angazhues për të gjithë pjesëmarrësit. Programacioni duhet të jetë angazhues, me elemente novatore dhe i veçantë në llojin e tij. Moderatorimi dhe programacioni do mbahen në gjuhën angleze.

Eventi ku kërkohet angazhimi i moderatorit do të zgjasë nga ora 10:00 deri në orën 17:00, në datën 27.03.2025.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati:

- të jetë shtetas shqiptarë;
- të kenë mbi 5 vite eksperiencë pune në fushën e moderimit;
- të kenë fituar një profil të rëndësishëm kombëtar në fushën e kërkuar;
- të ketë aftësinë të ideojë dhe realizojë një programacion angazhues për pjesëmarrës të rëndësishëm nga bota e biznesit;
- të jetë njohës dhe folës i shkëlqyer i gjuhës angleze;

Dosja e aplikimi duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtme:

- Jetëshkrimi/Curriculum Vitae;
- Dokumentacioni që vërteton eksperiencën të mëparshme në punë të ngjashme, si kontrata, etj;
- Fotokopje ID/Pasaportë;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Projekt-propozim të detajuar të programacionit
- Buxhet i detajuar për shërbimin.

Kjo thirrje do të qëndrojë e hapur deri më 17.03.2025, ora 16:30.

Procedura e Përzgjedhjes

Projekt-propozimet e paraqitura do të shqyrtohen nga një komision i përbërë nga 3 (tre) anëtarë. Fituesi do të shpallet më datë 20.03.2025.

Gjatë përzgjedhjes do të merren parasysh:

- karriera e moderatorit;
- aftësia e tij për të moderuar dhe realizuar programacionin në event;
- vlerat artistike të propozimit, të programacionit, ku një theks i veçantë do t'i vihet forcës konceptuale dhe evokative të programacionit;
- realizueshmëria financiare në kontekstin e burimeve në dispozicion.

Aplikimi dhe dorëzimi i dosjes së aplikimit me të gjitha dokumentat e cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.